

**KALLËZIM PENAL**

**KALLZUES:** PARTIA DEMOKRATIKE DEGA FIER

**ME OBJEKT:** Kallëzim i veprës penale, Neni 248 "Shpërdorimi detyrës" Neni 328 " Dhënia e premtimeve dhe shpërblimeve", Neni 328/a "Detyrimi për pjesmarrje në veprimtari politike", Neni 329 "Kanosja e zgjedhësit".

**KUNDER:** [REDAKTUAR] banues ne Frakull Fier nr telefoni [REDAKTUAR]

**DREJTUAR:** PROKURORISË PRANE GJYKATES SE SHKALLES SE PARE FIER

I nderuar Z. Prokuror,

Bazuar në nenet 280, 283 , si dhe neneve 248 ,328 ,328/a dhe 329 të Kodit Penal, parashtrojmë këtë kallzim penal për veprat penale të sipërcituar, duke parashtruar rrethanat e fakteve konkrete ku bazohet kallëzimi, provat me të cilat vërtetohen këto fakte si dhe dispozitat ligjore penale të cënuara.

**I. LIGJI I APLIKUESHEM**

**1.1.** Kodi i Procedurës Penale, në nenet 280, dhe 283 parashikon se:

*Neni 280*

***Marrja dajeni për veprën penale***

*Prokurori dhe policia marrin dajeni për veprën penale me iniciativën e vet dhe me njoftimin e bërë nga të tjerët.*

*Neni 283*

***Kallëzimi nga ana e shtetasve***

*Ëdo person që ka marrë dajeni për një vepër penale që ndiqet kryesisht duhet ta kallëzojë atë. Në rastet e caktuara me ligj kallëzimi është i detyrueshëm.*